



Data: 20.06.2018

Ref.: 655/18D

Në mbështetje të; nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16.09.2010), nenit 7 dhe nenit 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 09/2017, datë: 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 56-të, të mbajtur më 11 Qershor 2018, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Nr. 534/18 H, datë: 29. 05. 2018, për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së Nr. 564/17, datë: 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit Nr. 564/17, datë: 06.07.2017, për programin e studimit:
 - Konstruksione dhe Mekanizim, BSc, 180 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studentëve në programin e cekur në pikën dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së, Nr. 564/17, datë: 06. 07. 2017, mbetet e pandryshuar.

Arsyetimi

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me datë: 29.05.2018 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së, Nr.564/17, datë: 06.07.2017, me të cilin vendim Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i është pezulluar akreditimi për programe të studimit të cekura në vendimin përkatës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, është konstatuar që programi i studimeve i cekur më sipër i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me nenin 26, pika 5.3.4. të Udhëzimit Administrativ për Akreditim e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 9/2017, datë: 02.08.2017).

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me datë: 11 Qershor 2018, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

